



HISTORI SUKSESI AKTIVIZIMI I ALUMNES EDLIRA GJONI
NË NDIHMË TË FAMILJEVE TË PASTREHA

Një qytetare aktive për rindërtimin nga tërmeti

ASP

Një qytetare aktive për rindërtimin nga tërmeti

Tërmeti i fuqishëm i 26 nëntorit dhe pandemia e Covid-19, janë dy ngjarje që kanë lënë shenjë në tyre në ndërveprimin dhe marrëdhëniet sociale të shoqërisë sonë. Në këto momente të vështira, e kemi kuptuar edhe më shumë rëndësinë e besimit tek sistemet publike sociale dhe shëndetësore, por edhe vlerën e bashkëpunimit njerëzor për të ofruar ndihmë për këdo që ka më shumë nevojë si dhe orientim dhe shpresë për të ardhmen.

Në këtë edicion të revistës, kemi menduar të provojmë një histori të tillë njerëzore, historinë e suksesit të alumnes Edlira Gjoni. Kësaj here, jo në formatin e zakonshëm të profesionistëve të arsimës në fushën e komunikimit dhe liderimit, lektore universitare apo trajnueses ndërkombëtare. Përmbi këto aftësi dhe eksperiencat personale të saj, besojmë se është me vlerë të promovojmë më tej Edlirën aktiviste në ndihmë të familjeve të prekura nga tërmeti. Angazhimi saj personal prej më shumë se një viti në sensibilizimin e publikut, mbledhjen e ndihmave dhe shpërndarja e tyre edhe në kushtet e pandemisë, kanë shërbyer si një shkëndijë shprese jo vetëm për ato familje të mbetura të pastreha në zonën e Ishmit pranë Durrësit.

I kërkuam Edlirës, dhe kush më mirë se vetë ajo mund ta bënte, që ta përshkruante rrugëtimin e saj mbi njëvjeçar të aktivizimit me familjet e prekura nga tërmeti.

Angazhimi njëvjeçar i alumnes së Shkollës së Studimeve Politike Edlira Gjoni në ndihmë të familjeve të mbetura të pastreha në Durrës

Nuk ka lumturi më të madhe se të jesh njeri për njerinë

Nga Edlira Gjoni

“Të nesërmen e 26 Nëntorit 2019, nuk më mbante shtëpia. Nuk po e përballoja dot nga ekrani numrin e viktimave që rritej çdo orë. Mpirja mund të dilte vetëm me mpirje. Instikti njerëzor e ai profesional thërrisnin me forcë të dilja. Të shkoja “atje”, te vendi i ngjarjes. Morëm makinën me bashkëshortin për te epiqendra e tërmetit, në zonën e Ishmit, mes Durrësit, Krujës e Tiranës. Vetëm 3 kilometra pasi lamë Rinasin, hymë në kthesën për në Bubq. U dukën menjëherë shtëpitë e para disa katëshe buzë rrugës, me tulla të rëna, mure të krisura, tavane të rrëzuar, veranda që kishin zënë nën vete çimentot e kateve të para.

Mezi e kaluam Bubqin e ngarkuar me makina, kamera televizive, furgonë me ushqime, makina ushtrie me çadra dhe një qendër provizore që ishte ngritur me



shpejtësinë e erës e shpërndante ushqime e roba. “Nuk ndalim këtu jo! Ka ardhur gjithë Tirana, ngaqë e ka sjellë një aktor humori. Të ikim më tutje. Me siguri ka familje e jetë edhe më tej” – këmbëngula me instinkt të fortë për të vijuar. Në Mazhë, Murqinë e Mallkuç ishte e njëjta





gjendje: shtëpi të rrëzuara e mure të kri-sur diagonalisht e tejpertej. Lajmet në radio flisnin për viktime që shtoheshin.... Tabela buzë rrugës nuk kishte më, teksa filluam të merrnim shumë ngadalë kodrën që të çonte drejt Ishmit. Asgjë nuk

më kishte sjellë më parë në këtë zonë kaq afër e larg Tiranës. E shihja me sy të hapur nga habia. Buzë rruge, një shtëpi e vjetër, e shembur e tëra nga brenda. Tullat kishin zënë poshtë vetes një grumbull të madh e të njomë me bar. Të shumta shtëpitë që dukeshin të pabanuara.

të 60-ave ishte ulur në mes të baltës. Në krahë shtrëngonte një foshnje që qante pa pushim. Bri këmbëve, disa hunj zjarri që sapo i kishte fikur shiu. Përballë saj, muret dhe tavani i shembur i një shtëpie një-katëshe, lyer ëmbël me ngjyrë rozë. Nuk ka forcë, as fjalë, as ide në ngjarje të tilla. Gruaja fërkonte kokën e foshnjës dhe e tundte sa para pas, por më shumë ngushëllonte veten sesa foshnjën. Ende nuk na kishte vënë re, kur na u afrua i zoti i shtëpisë, Baftjari bashkë me të birin, Zanin, e me nusen e tij, Denisën.

Gruaja ishte Sofia, më e forta grua që kam njohur në gjithë kohën pas tërmetit. Në krahë shtrëngonte mbesën, e lotët nuk i shternin. "Është vetëm 5 muajshe, zemra e nënës. Na vrau. Na zuri kokën. Na mori shtëpinë....." Shpirti njerëzor i tëri i zhveshur, i hapur, i nderë në qiell të hapur në atë pamje.

Kishin ndjerë tërmetin e parë rreth orës 2.00 pas mesnate, e nusen nuk e zinte më gjumi nga tronditja. Nënë Sofia i mori vajzën në dhomën e vet, që Denisa të qetësohej e të flinte. Në 4 pa 3 minuta, Denisa ishte ende zgjuar. Shtëpia u



Ndaluam t'i bëja foto. Nuk rreshtte aparati. Mbi të, një shtëpi tjetër pa zë e pa dëmtime të dukshme, por me atë X-in e madh në muret e jashtme, që siç e mësova më pas, qenkej shenjë e dukshme që shtëpia nuk ishte më e banueshme. Akoma sipër saj, në kodër, mezi dukeshin disa mure të bardha. "Shkojmë atje" – shqiptova, më shumë me frikë sesa me ndonjë ide të qartë në kokë. Por makina nuk ngjitej aq lart. A isha e sigurt që doja të shkoja? Pa asnjë hezitim! M'u duk se shihja lëvizje njerëzish nga lart. E pikërisht atje duhet të shkoja, ku nuk kishin mbërritur VIP-at, kamerat, politikanët apo ushtritë me çadra. Atje ku ende nuk kishte shkuar askush! Ngjitja ishte e pjerrët, me baltë, e vështirë dhe e ngarkuar me pikëpyetje.

TAKIMI I PARË MË DERAJNËN E VOGËL
Pak mbi mesin e kodrës, një grua rreth



Kontributi i alumëve të Shkollës mundësoi seancat e logopedisë për Ensuelën, një tjetër fëmijë që jetonte në çadër në zonën e dëmtuar nga tërmeti në Ishëm

shkund menjëherë. Muret u shkëputën anash. Zhurma ishte ulëritëse. Denisa nuk mban mend asgjë, veçse kur e kishte gjetur veten jashtë. Dhoma e tyre ishte e para pranë derës së jashtme. Por Derajna e vogël nuk ishte. As Sofia jo! Dera e jashtme ishte mbyllur për një moment e Sofia me foshnjën në krah, thërriste nga brenda. Kuzhinës i ra në tokë gjithë tavani. Muri i pasmë i saj shpartalloi qëndrimin në këmbë. Muret në dhomën e Sofisë kërcisnin duke ushtruar presion mbi dollapin, mbi derën, mbi aftësinë e saj për të dalë jashtë.

Në pakëz sekonda vendimtare, babë e bir hapën derën e ndihmuan të dilnin jashtë nënën me foshnjën e vogël. Pas tyre, muret, tjegullat e trarët vijon të të binin, të çaheshin, të kërcisnin me uturimë. Para syve të tyre u shemb shtëpia që Baftjari e Sofia mezi kishin ndërtuar një jetë të tërë. Bashkë me muret, u shemb edhe një pjesë jete e qetësie e familjes Kulla, në kodërzën e vogël të Ishmit.

Afër mëngjesit, djali ndezi një zjarr të vogël, në qiell të hapur. Ishte fundi i nëntorit. I ftohti në kodër ishte i ashpër për foshnjën. Shtruan ç'gjetën në baltë e atje e gjeta Sofinë. Të pa lëvizur. Me sytë ngrirë drejt shtëpisë që për pak sekonda,

desh i mori jetën: asaj, të birit, të shoqit, nuses e foshnjës së vogël. Vërtet, askush nuk kishte shkuar ende në atë skenë drame njerëzore.

I përqafova me dënesë. Mora Derajnën në krahë. U dhashë ato pakëz ushqime të ngrohta që kisha mundur të merrja me vete. Pashë ullinjtë e shpërndarë gurëve, copat e pjatave, gotave, dritareve, enëve të bëra copë e çikë, në pjesën e shembur të kuzhinës. Tavani u kishte rënë sipër dhe i kishte rrafshuar të gjitha.

NEVOJITEJ VEPRIM

Fillova të bëj disa telefonata. Mesazhe. Të kërkoja mendim. Ndihmë. Ide.... Mora leje të postoja Sofinë dhe Derajnën, me shpinë. Menjëherë Alda hapi rrugën që të shkoja te Bieta, në Ftesë në 5, në Top Channel. Fotot e Kullasit dhe Derajnës së vogël, morën dhenë. Në studio, një zotëri fisnik. Pa mbaruar emisioni, premtori se së bashku me bashkëshorten soprano dhe vajzën e tij të vogël, do i blejnë Derajnës një kontejner. As e kisha dëgjuar ç'ishte. Kalvari i gjetjes, transportit dhe montimit të tij më çoi sërish në Ishëm. Derajnës i kishin çuar ndërkohë një çadër, por familja ishte e tëra mbi baltë, edhe brenda saj. Kontejneri ishte bekimi i parë, i pa ndeshur për familjen. Teksa ai vendosej, lotët

e Sofisë u bënë legjendë. Së bashku me vrapin e saj pas meje, sa herë që vija e ikja, duke i çuar njerëz e dashamirës që nisur nga rrjetet sociale, më kërkonin ta mbështesnin drejtpërdrejt familjen.

Unë çoja veten, fjalën, njerëz apo kontribut të vogël, aq sa njerëzit kishin mundësi, Sofia përherë më qepej poshtë kodrës me vrap "Pash Zotin prit të të jap disa vezë. I kam nga pulat e mia". Kësaj familjeje fisnike, të rrënuar e zënë poshtë, i kishin ngelur vetëm pulat. E vetmja pasuri! E ajo edhe ato donte t'i dhuronte. Me aq sa kishte. Zemrën në dorë, nëna e sakrificave shqiptare. Pas çdo vizite, rrjetet sociale dhe miqtë dashamirës në media bënë punën e vet. Pas rrobave e enëve nga Teatri, erdhën ngrohësja e dysheku, pastaj tavolina e pajisjet e vogla, më pas paratë e një shfaqjeje zemre nga Drieda, kontributi i të voglës emigrante Fabiola dhe premtimi për dhomën e Derajnës nga Flutura. Këtu puna ngeli në vend.

Nga Durrësi, me shtëpi të dëmtuar, Iliri u ofrua të paguante ndërtimin e shtëpisë nga themeli. Me paratë e veta nga biznesi i vogël privat. Një vit të tërë, nuk ngeli inxhinier e inspektor që nuk e vizitoi kodrën e vogël. Por leja e ndërtimit nuk doli dot. Deri sa më në fund, në mes të tetorit 2020, kur dimri i dytë po u trokiste në kontejner, familja Kulla pa grupin e punës të ngjiste kodrën e tyre.

E kam cilësuar si arritjen më të madhe të vitit. Në 2020-ën kapërcyem pandeminë, mora çmim, fitova debate, shkrova, argumentova plot. Por asnjë arritje nuk krahasohet me ditën kur Sofia më nisi foto të themelit të ri që ishte hedhur sipër shtëpisë së rrëzuar që gjeta 15 muaj më parë.

Rindërtimi i kësaj shtëpie u bë sfida ime personale. Premtimet, sms-të e "qetësimet" nga miq e gati-miq me pushtet, rrëzoheshin të gjitha. Televizionet u



Derajna, vajza e vogël e familjes Kulla, e mbetur e pastrehë nga tërmeti në fshatin Ishëm në Durrës. Shtëpia e saj ashtu si shumë të tjera në zonë është ende në ndërtim



treguan miqësore e Nano, Salaj, Alishani, Hila nuk e kursyen hapësirën dhe fjalën. Por, asgjë nuk ecte.

Ndërkohë, puna me Derajnën solli një lumë kërkesash e besimi të ri tek puna në terren, atje, tek balta e Ishmit. Ndaj pas saj, kontenierët filluan të vinin nga shumë kahe, si bekim për të gjitha familjet që fillova të njoh e miqësoj në Ishëm, në Gjericë, në Kodër-Bizë. Irisi çoi personalisht kontejnerin tek Iliada dhe Orkida, motrat 3 dhe 5 vjeç ngelur pa çati mbi kokë. Pastaj erdhi Ermira që nga Amerika e mes gjithë njerëzve që punonin për tërmetin, më gjeti e me një këmbëngulje të admirueshme, porositi, bleu e shpërdau kontenierë e ndihma për 11 familje.

Fluturoja për tek të gjithë. Iniciativë personale, humane, njerëzore, nxitur nga Derajna, e thelluar nga të gjithë njerëzit në nevojë, por me zemër aq të madhe që njoha në Ishëm. Mes tyre, edhe Ensuelën, 8-vjecaren me kaçurrelat e zeza, me sytë e mëdhenj plot dritë dhe vështrimin lutës të të ëmës për ndihmë. Kolegët e Akademisë Së Studimeve Politike nuk hezituan

asnjë sekondë: i dhuruan familjes pagesën për 10 seanca logopedie, për të lehtësuar sadopak barrën psikologjike të pas-tërmetit.

THEMELET E SHTËPIVE TË REJA

Ensuela vijon të bëjë trajtim të specializuar logopedik. Edhe Derajna është rritur e mësoi t'i hedhë hapat e parë në baltë, në kontenier apo mes grupeve të emergjencave që shkonin e vinin me shkresa në duar, pa zgjidhur gjë.

Ama sot Sofia më tregon një listë që mban poshtë jastëkut. Ka emrat e të gjithë njerëzve që iu përgjigjën kauzës e



pranuan të vinin me mua deri në Ishëm, apo që më besuan të mbaroj porosinë e tyre, me video live që lejon teknologjia.

"Do t'i gdhend këta emra në këto kornizat që bëhen me shkrim hieroglif. Më kanë treguar edhe ku bëhen. Të gjithë do i gdhend, e do jetë korniza e parë që do vendos në shtëpinë e re. E nuk e di nëse do më vijnë, por ne do i ftojmë të gjithë, veç kur të vijë ajo ditë që do futemi brenda. Do therim viçin ne. Atë të vetmin që kemi. Për këtë ditë rritet ai".

Nuk e mbaj më mend numrin e vizitave të mia në Ishëm. As numrin e njerëzve të mirë që më besuan e së bashku ndihmuam kaq shumë familje. Pa bujë. Pa deklarata. Pa pagesë. Pa asnjë projekt. Pa asnjë përfitim monetar. Pa asnjë shtysë, veç dëshirës së brendshme për të qenë njeri, pranë njerëzve që kanë nevojë. Pas Sofisë, foto me themele shtëpish më nisi edhe Irena. Edhe Artemisa. Edhe të tjera. Nuk ka lumturi më sublime në jetë sesa kur shikon të realizuar një mision kaq të thjeshtë: të jesh njeri për njerinë! Faleminderit! "

Këshilla të qarta në kohë të turbullta


Gjatë periudhës së vështirë të pandemisë së Covid-19, ASP u fokusua në mbajtjen gjallë të komunikimit me pjesëmarrësit dhe alumnët. Kjo periudhë izolimi dhe rritja e aftësisë për përdorimin e platformave online, ishte një mundësi e mirë për zhvillimin e diskutimeve periodike online me alumnët mbi pasojat e pandemisë në nivelin e demokracisë, por edhe zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Këto diskutime shërbyen si bazë për krijimin e grupeve të përbashkëta kërkimore të alumnëve me qëllim bashkëpunimin dhe ofrimin e kontributit profesional me analiza dhe punime rekomanduese ndaj vendimmarrësve dhe aktorëve të ndryshëm.

Më konkretisht:

- **Diskutimi "Sfidat dhe mundësitë e arsimit në internet"** u fokusua mbi sfidat me të cilat përballëj arsimi në kalimin e edukimit online në kushtet e izolimit nga COVID-19. Si bazë për këtë debat shërbeu një punim kërkimor i titulluar "Ndikimi i digjitalizimit në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve", i përgatitur në tetor 2019, si pjesë e iniciativave publike të pjesëmarrësve të ASP. Dokumenti u botua dhe u shpërnda gjerësisht duke ofruar një kontribut praktik për këtë çështje të rëndësishme në kohë pandemie.

Grupi i punës përbëhej nga alumnët: Blerina Guga, Edita Shoshi, Elkana Zyka, Saniela Xhaferi, Zoica Bardhi, Bjorka Duka dhe Alsaed Sinani.

- **Diskutimi "Shteti i së drejtës në gjendjen e emergjencës"**, synoi të analizonte fushëveprimin ligjor dhe fuqinë e Ekzekutivit gjatë muajve të parë të emerg-



Diskutimet online të alumnëve gjatë pandemisë

jencës si rezultat i pandemisë. Në vijim të diskutimit, u krijua një grup alumnësh me ekspertizë juridike, të cilët finalizuan një dokument rekomandues, i cili u shpërnda tek shumë aktorë vendas dhe të huaj dhe ngjalli edhe interesimin e mediave për këtë çështje të rëndësishme.

Grupi i punës përbëhej nga alumnët: Isuf Shehu, Blerina Fani, Eugen Pepa, Ledio Braho dhe Edlira Gjoni.

- **Diskutimi "Ndikimi i pandemisë COVID-19 në ekonominë shqiptare"**, nxitte një grup alumnësh për hartimin e një punimi kërkimor mbi sfidat dhe mundësitë e ekonomisë shqiptare për të përballuar krizën e shkaktuar nga pandemia. Alumnët zhvilluan një analizë të plotë të situatës aktuale, burimeve si dhe kapac-

iteteve për të kapërcyer ndikimin e COVID-19. Disa nga rekomandimet e afuara synuan që t'ju vijë në ndihmë politikëbërësve në këto momente kur po diskutohen masat dhe reformat e nevojshme për të rimëkëmbur ekonominë shqiptare.

Grupi i punës përbëhej nga alumnët: Enton Duro, Ornella Liperi, Altin Hoti dhe kolegu Eduart Gjokutaj.

Këto punime u transmetuan zyrtarisht nga ASP tek institucionet kryesore vendimmarrëse si dhe grupet e interesit sipas fushave respektive. Gjithashtu gjetjet e konstatuara u publikuan gjerësisht në mediat kombëtare dhe kanalet e komunikimit në mediat sociale të ASP. Punimet e plota mund të konsultohen në rubrikën Publikime në faqen e internetit të Akademisë (detajet e mëtejshme ndodhen në faqen e fundit të revistës).



VITI 2007

EMRI	POZICIONI *
Z. Alban Tartari	Zëvendëskryeredaktor i Televizionit Publik Shqiptar, TVSH
Z. Albert Faruku	Deputet
Z. Alfred Gega	Deputet
Z. Andi Krraqi	Kreu i Forumit Rinor të Partisë Demokratike
Z. Arben Haveri	Drejtor i NBG Bank në Shkodër
Z. Arben Lagreta	Gazetar
Z. Arben Porocani	Ass. Lektor pranë Universitetit të Tiranës
Z. Arben Shkodra	Drejtor i Administratës dhe Shërbimeve, Këshilli i Ministrave
Znj. Arbëresha Mushani	Mësues
Znj. Ardiana Kasa	Menaxhere Programi, organizata "Eorld Vision"

Z. Artemon Cukalla	Kreu i Forumit Rinor të Partisë Aleanca Demokratike
Z. Artur Hasanbelliu	Deputet
Z. Artur Kopani	Drejtor i Televizionit Publik Shqiptar, TVSH
Znj. Blerina Balilaj	Specialiste pranë Institutit Demokratik Kombëtar - NDI
Znj. Blerina Tepelena	Kreu i sektorit të monitorimit të strategjisë për komunitetin Rom
Znj. Elga Mitre	Specialiste pranë ambasadës holandeze në Tiranë
Znj. Elma Tershana (Shehu)	Drejtoresh e Programit për mbikëqyrjen e të drejtave të Fëmijëve (UNICEF)
Z. Elton Halimi	Pedagog në Fakultetin e Shkencave, Universiteti i Tiranës
Z. Endri Jorgoni	Këshilltar, Ministria e Transportit, Punëve Publike dhe Telekomunikacionit

Z. Erjon Meta	Analist pranë misionit policor ICITAP
Znj. Ersejla Murati	Gazetare, "Koha" TV
Z. Gramos Qendro	Specialist në Ministrinë e Transportit, Punëve Publike dhe Telekomunikacionit
Znj. Iva Hyseni	Juriste, Drejtoria e Studimeve, Publikimeve dhe Informacionit në Gjykatën e Lartë
Znj. Kimete Klenja	Koordinatorë programesh pranë organizatës UNIFEM
Z. Kostandin Kazanxhi	Jurist
Z. Ledion Kola	Asistent shërbimi ndaj klientit (ABA)
Znj. Lindita Luzo	Koordinator Projekti në PNUD
Znj. Sidita Gipali	Konsulente lokale për Ministrinë e Shëndetësisë
Z. Teki Kurti	Kryetari i Këshillit të Komunes Martanesh



VITI 2008

Znj. Arbana Dibra	Drejtoreshë ekzekutive e zyrës së OSBE-së në Shkodër
Z. Arben Vata	Kryeredaktor, "Ora Neës" TV
Znj. Beslinda Rugia	Asistent avokate
Z. Bledar Kurti	Lektor pranë Universitetit të Tiranës
Znj. Brasena Koka	Koordinatorë projekti pranë organizatës "Eorl Vision"
Znj. Brunilda Minaroli (Peci)	Specialist në departamentin për marrëdhëniet ndërkombëtare, Ministria e Jashtme
Znj. Edlira Gjoni	Koordinatorë projektit EU-CARDS VET tërënjë / Gazetare
Znj. Edlira Mali	Drejtor Ekzekutiv e degës së kompanisë "Ogilvy" në Tiranë
Znj. Edlira Papavangjeli	Koordinatorë Programi pranë organizatës Komiteti i Helsinkit

Znj. Elda Zotaj	Asistente Administrative në Universitetin e Tiranës
Z. Elson Thana	Oficer i Policisë Gjyqësore
Znj. Elvana Zhezha	Shef i Kabinetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme
Znj. Eralda Cani Methasani	Lektore në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Z. Erion Avllazagai	Lektor në Universitetin e Elbasanit
Z. Erjon Tase	Analist Politik në "Gazeta Shqiptare"
Z. Erlis Cela	Gazetar në gazetën "Standard"
Z. ERVIN KARAMUCO	Zëvendëskomisioner pranë "Avokatit të Popullit"
Znj. EVIS FICO	Shef i Sektorit për Emigrimin në Shërbimin Kombëtar të Punësimit
Z. FLIR MOSHO	Drejtor i Menaxhimit të Investimeve Publike në Ministrinë e Financave

Znj. GENTIANA RAMADANI	Drejtoreshë ekzekutive e organizatës "Gratë për gratë"
Z. GJERGJI TANE	Drejtor i Zyrës lokale të punësimit në Korçë
Z. GJOK VUKSANI	Deputet
Znj. IVIS NOCKA	Shef në Sektorin e Monitorimit, Ministria e Mbrojtjes
Z. KLODIAN RJEPAJ	Koordinator Kombëtar në Institutin e Shëndetit Publik
Znj. KLODIANA GJINAJ	Këshilltare për mediat pranë KESH
Z. MARIN MEMA	Gazetar "Top Channel"
Znj. MONIKA STAFI	Gazetare "Top Channel"
Znj. NAHLEL BEJLERI – FICO	Inspektore në Shërbimin Social Shtetëror
Z. OLSI KARAPICI	Drejtor i Departamentit të IT në Këshillin e Ministrave
Z. REMZI ALIAJ	Drejtor rajonal i Shërbimit Social Shtetëror



Z.	REZART LAHI	Drejtori i Përgjithshëm i "Shijak TV"
Znj.	SANIJE FATKOJA HAXHIHYSENI	Menaxhere dege e "Opportunity Albania"
Znj.	VILMA PREMTI	Drejtoreshë në Ministrinë e Punëve, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

VITI 2009

Z.	Adrian SHEGA	Asistent avokat, Shërbimi ligjor falas Tiranë
Znj.	Admira Poci	Specialiste pranë Institutit Goethe
Znj.	Albana HANA	Specialiste në Ministrinë e Integritetit
Znj.	Ana XHEKA	Drejtoreshë në Ministrinë e Punëve, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
Znj.	Ardita SHEHAJ	Shef departamenti, Autoriteti i Konkurrencës
Znj.	Beti NJUMA	Gazetare, "Top Channel"
Z.	Blerim KOLA	Kryeredaktor, Nesër TV
Z.	Edvin SHVARC	Drejtor i Informacionit Publik dhe Protokollit pranë Presidentit të Republikës

Znj.	Elira CANGA	Gazetare, "Gazeta Shqiptare"
Znj.	Elsa TOSKA (DOBJANI)	Këshilltare Ligjore në Gjykatën Kushtetuese
Znj.	Entela HAMITI	Anëtare e Partisë Socialiste
Znj.	Erinda SHAH	Anëtare e Partisë G99
Z.	Ermal GJINAJ	Kreu i departamentit të marrëdhënieve publike në Ministrinë e Ekonomisë dhe Energjisë

Z.	Eugen Pepa	Këshilltar Ligjor në Parlamentin Shqiptar
Z.	Genc HOXHA	Supervizor i Shërbimit të Rrjetit, Vodafone Albania
Z.	Gentian ISLAMI	Drejtor i Planifikimit Urban, Bashkia Kuçovë
Z.	Gentian MANO	Menaxher i organizatës "Eorl Vision", Librazhd
Znj.	Gerta META	Drejtoreshë Ekzekutive e Shoqërisë për Kulturë Demokratike (SHKD)
Z.	Hysni AHMETAJ	Specialist në Ministrinë e Integritetit
Z.	Ilir TOPI	Aktivisti i Forumit Rinor të Partisë Demokratike
Znj.	Ingrit PRIZRENI	Shtëpia Botuese "Media Print"

Znj.	Liliana ALIMETA	Shef për kontratat dhe procedurat për donatorët, Ministria e Financave
Znj.	Mimoza KOCIU	Këshilltare për medianë, zëdhënëse e zyrës së Presidentit të Republikës
Z.	Plarent RUKA	Këshilltar Ligjor, Ministria e Shëndetësisë
Znj.	Plejada GUGASHI	Menaxhere Programi për OLOF Palm International Center Albania
Z.	Redi BADUNI	Kreu i Sekretariatit të Rinisë në Partinë Republikane
Z.	Redi SKENDERAJ	Gazetar, Koha TV
Znj.	Rezarta GODO	Programi "Brain Gain", PNUD
Znj.	Sonila MECO	Gazetare, Klan TV
Z.	Urim BAJRAMI	Kryeredaktor i Gazetës "Shqip"

VITI 2010

Z.	Afrim Kola	Shef i Kontrollit Ajror në Forcat Ajrore Shqiptare
Z.	Alban Fishka	Specialist në Inspektoriatin Teknik Qendror
Znj.	Aleksandra Bogdani	Kryeredaktore në "Top Neës" TV



Znj. Anila Shqypi	Koordinatorë projekt, GTZ Albania	Z. Evarist Beqiri	Specialist ligjor pranë Shërbimit Informativ Shtetëror	Znj. Klotilda Neziri	Shef kabineti në bashkinë e Pogradecit
Z. Arber Kadia	Drejtor në Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare në Tiranë	Znj. Fatjona Mejdini	Gazetare, "Shqip"	Z. Ledio Milkani	Këshilltar Ligjor për Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë
Z. Besjan Pesha	Këshilltar i kryetarit, zëvendës-sekretar i Përgjithshëm i LSI	Z. Fjorel Como	Specialist në Ministrinë e Transportit/aktivist në Forumin Rinor të PD-së në qytetin e Gjirokastrës	Znj. Migena Muhaj	Koordinatorë në programin Seiss Partnerships in Health
Z. Bilbil Keraj	Shef i kabinetit në Bashkinë Kukës	Z. Genard Kastrati	Drejtor Ekzekutiv në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve	Znj. Migena Nelaj	Drejtorë për median dhe marrëdhënien me publikun pranë KESH
Znj. Blerta Gjermani	Kryeredaktore, ORA Neës TV	Znj. Giomela Gjini	Drejtor Teknik në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave	Z. Ols Lafe	Drejtor në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
Z. Dritan Nushi	Zyra e Prokurorit, Rrethi Kavajë	Z. Ilir Paco	Gazetar "Top Channel"	Znj. Oriana Arapi	Koordinator për Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit dhe Integrimin në Këshillin e Ministrave
Znj. Eglantina Bisha	Specialiste pranë Qendrës së biznesit "Eurocol"	Znj. Irena Kita (Dimushi)	Specialiste ligjore në Bankën Credins	Z. Qemal Cejku	Shef kabineti në Bashkinë e Kamzës
Z. Elton Lula	Menaxher Projekti pranë Shërbimit Ligjor falas në Tiranë	Znj. Jonida Shehu	Gazetare në "Vizion Plus" TV	Znj. Rozana Celmeta	Kreu i Marrëdhënieve me Publikun në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave
Znj. Enina Mullaj	Specialiste në departamenti ligjor në Parlamentin Shqiptar	Znj. Karolina Risto	Kryeredaktore e Vizion Plus TV	Z. Saimir Shatku	Këshilltar ligjor për administrimin në Këshillin Bashkiak të Tiranës
Z. Enkes Shundi	Këshilltar, Shef i Protokollit të Presidentit të Republikës	Znj. Klodiana Thartori	Koordinatorë Programi "Save the Children"		
		Z. Klodjan Seferaj	Këshilltar në Këshillin e Ministrave		



Znj. Suela Cela

Specialiste në departamentin ligjor në Ministrinë e Bujqësisë

Znj. Erjola Muka

Kreu i Sektorit të Politikave të Mjedisit, Bashkia Tiranë

Z. Qamil Dika

Kreu i Këshillit Studentor Kombëtar / Aktivist I PD

Znj. Rajmonda Lajthia

Gazetare, "Vizion Plus" TV

VITI 2011

Znj. Ada Ramaj

Ndihmëse e zv.ministrit të Brendshëm

Z. Genti Çani

Drejtor në Drejtorinë e Mbrojtjes së Pronës Intelektuale, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

VITI 2012

Znj. Albana Shtylla

Shefe kabinetit në Zyrën e Avokatit të Popullit/ Anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Znj. Albana Veizi

Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Presidentit të Republikës

Z. Gentian Xhaxhiu

Gazetar "Shijak TV"

Znj. Alisa Demollari

Zëdhënëse/Ministria e Shëndetësisë

Z. Alvi Bajramaj

Specialist i Marrëdhënieve Publike, QSUT

Znj. Gresa MARTIRI

Juriste pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë

Z. Altin Hoti

Lektor i Ekonomisë Ndërkombëtare në Universitetin Mesdhetar/ Universitetin Evropian

Znj. Anxhela Andoni

Aktiviste e Forumit të Gruas të Partinë Socialiste, rrethi Pogradec

Z. Helidon BELE

Drejtor në Tirana Bank

Z. Altin Ibro

Jurist/ Celibashi Consulting shpk

Z. Arlind Lugji

Specialist në Zyrën e Rregjistrimit të Pasurive

Z. Ilir Stojku

Specialist në Sektorin e Koordinimit, Ministria e Drejtësisë

Z. Andi Seferi

Drejtuues i Komunitetit të Sant'Edigio në Shqipëri

Z. Arnold Hajro

Jurist vendor pranë Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO)

Znj. Klesta Hysi

Koordinatorë programi pranë organizatës "Fëmijët Sot"

Znj. Anisa Seferaj

Juriste/ Bashkia Tiranë

Znj. Daniela Mehmeti

Juriste pranë Autoritetit Kombëtar të Konkurrencës

Z. Kreshnik Ternova

Administrator, ALK Pharma sh.p.k.

Znj. Ardita Kongjonaj

Specialiste në Agjencinë Kombëtare për Ekzaminimin, Ministria e Arsimit

Znj. Enila Hasani

Shefe në Departamentin e Marrëdhënieve me Jashtë në Ministrinë e Brendshme

Znj. Ledi Jahja-Muçë

Administratore pranë organizatës SNV në Shqipëri

Z. Arian Galdini

Kryetar i FDE, Partia për Liri, Demokraci dhe Etikë / Lektor pranë Universitetit Luarasi

Z. Enio Haxhimihali

Shef kabinetit në Këshillin Kombëtar të Radio-Televizionit

Znj. Merita Mansaku-Meksi

Oficer Programi, Zyra Austriake për Zhvillim

Znj. Baisa Sefa

Kërkuese pranë organizatës Lëvizja Evropiane në Shqipëri

Znj. Mirjam Reçi

Drejtoreshë ekzekutive pranë organizatës CSDC Durrës

Znj. Olta Blaceri

Kryeredaktore e programit "Ora e debati" në "Ora Neës" TV

Z.	Elidon Laze	Drejtor në Drejtorinë e Ligjore dhe të Apelit në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Patundshme
Z.	Erlis Shahu	Specialist IT pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve
Z.	Ermal Simaku	Doktor / Anëtar i Forumit Rinor të Partisë Socialiste
Z.	Ermir Godaj	Shërbimi i Përmbarimit, Ministria e Drejtësisë
Znj.	Ervina Domi	Drejtor në Departamentin Ligjor të Drejtorisë të Përgjithshme të Doganave
Znj.	Eva Dauti	Juriste, Shoqata Shqiptare e Bashkive
Znj.	Florensa Haxhi	Koordinatorë e strategjive në Këshillin e Ministrave
Z.	Fredi Guga	Drejtor i Qendrës së Shëndetit në Durrës/Koordinator projekti në "Europartners Development"
Z.	Ilir Kondi	Drejtor i Qendrës së Publikimeve Zyrtare / Aktivist i Partisë Demokratike (PD)
Z.	Ilir Korbi	Jurist në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Patundshme
Z.	Ilir Mimani	Specialist në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore
Znj.	Jorina Gjinari	Menaxher Projekti tek Qendra e Studimeve Future
Z.	Ledio Braho	Jurist në Ministrinë e Integritetit/Asistent profesor në Universitetin e Tiranës
Znj.	Margarita Kola	Specialiste ligjore në Ambasadën Amerikane / Aktiviste e partisë politike Aleanca KuqeZi (AK)
Znj.	Mariola Qesaraku	Koordinatorë projekti pranë Instituti për Demokraci dhe Meditim

Znj.	Marsida Çela	Menaxher Programi tek Qendra e Fëmijëve SOT/Menaxhere në agjencinë e Shërbimeve sociale GC, NY, SHBA
Znj.	Merita Osmani (Muçaj)	Juriste në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës/Lektore në Universitetin Amerikan të Tiranës
Znj.	Mirela Karapici	Drejtor Marketingu dhe i Marrëdhënieve me Publikun në Postën Shqiptare
Z.	Oltion Kuke	Drejtoreshë Departamentit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave
Z.	Rezart Xhelo	Specialist pranë misionit të OSBE
Znj.	Romina Kuko	Asistent Projekti, OSBE
Znj.	Rovena Rojba	Inspektor Vlerësimi në Drejtorinë Rajonale të Taksave, Tiranë
Z.	Sokol Bega	Asistent politik, OSBE
Znj.	Suela Lala	Aktiviste në Shoqërinë Civile

VITI 2013

Znj.	Albana Hasanaj	Specialiste në Agjencinë e Zhvillimit të Investimeve në Shqipëri (AIDA)
Znj.	Amela Zaganjori	Arsimtare/Aktiviste në Partinë Demokratike (PD)
Z.	Armand Metani	Menaxher i Përgjithshëm i Milifar sh.p.k.
Z.	Arti Cicolli	Drejtor i IT-së në Presidencë
Z.	Basir Collaku	Këshilltar dhe Zëdhënës i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave
Znj.	Blerina Doracaj	Eksperte ligjore dhe prokurimesh në Agjensinë e Zhvillimit të Zonave Malore / Aktiviste në Partinë Socialiste (PS)
Znj.	Edlira Nasi	Specialiste në kompaninë Antea Cement / Aktiviste e të drejtave civile dhe të minoriteteve
Znj.	Elda Gjoka	Themeluese dhe drejtuese e kompanisë Genuine Effect

Znj.	Eneida Ahmeti	Avokate tek firma ligjore Shala/Aktiviste në partinë politike Aleanca Kuqezi (AK)
Znj.	Enkeleda Basha	Asistente në Gjykatën e Rrethit Shkodër/Aktiviste e Partisë Lëvizja Socialiste për Integritet
Z.	Erand Nebo	Departamenti i Leasing, Banka Societe General
Znj.	Ervis Rahmani	Lektor në Universitetin Kristal/Specialist në Ministrinë e Integritetit/Aktiviste në Partinë Socialiste
Z.	Fatmir Konja	Asistent në Zyrën e Presidentit të Republikës
Znj.	Florenca Korbi	Menaxhere Projekti në Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë
Z.	Jonito Bregasi	Kontrollor i Trafikut Ajror/ Aktivist në Partinë Lëvizja Socialiste për Integritet (LSI)
Z.	Jugert Jorgo	Nëpunës në Departamentin e Protokollit të Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme
Z.	Julian Llupo	Specialist në Autoritetin e Konkurrencës
Znj.	Klementina Cenkollari	Gazetare, "Ora Neës" TV
Z.	Oltion Pengu	Konsulent Lokal në Këshillin e Ministrave
Znj.	Sabina Juka	Eksperte në Këshillin e Ministrave
Znj.	Sentiljana Barzezi	Specialist tek CEZ/Aktiviste e partisë politike Fryma e Re Demokratike (FRD)
Znj.	Valbona Lasku	Menaxhere Zyre në BBC Tirana

VITI 2014

Znj.	Alma Binaj	Asistente pranë zyrës të deputetit Edi Rama në Vlorë
Znj.	Anisa Xhafa	Specialiste e marrëdhënieve publike pranë GIZ Albania/ Aktiviste e partisë FRD



Z.	Artur Bardhi	Specialist pranë Dep. Të Integritit, Ministria e Punëve të Jashtme
Znj.	Blerina Ago	Këshilltare e Ministrit të Drejtësisë
Znj.	Dorina Puto	Eksperte ligjore pranë Institutit të Presidentit të Republikës
Z.	Elvin Nuriu	Drejtor i administratës, Instituti i Sigurimeve Shoqërore / Aktivist i PDIU
Znj.	Erjona Rusi	Gazetare, Report TV
	Erton Graceni	Këshilltar për Teknologjinë pranë Këshillit të Ministrave
Z.	Ervis Mocka	Zv.dekan i Universitetit të Vlorës / Këshilltar i PS pranë Këshillit Bashkiak Vlorë

Znj.	Evis Shurdha	Drejtoresh e Administratës dhe Shërbimeve, Këshilli i Ministrave
------	--------------	--

Z.	Fabian Zhilla	Kërkues mbi krimin e organizuar / Lektor pranë Institutit Kanadez të Teknologjisë
----	---------------	---

Znj.	Gentiola Madhi	Kërkuese pranë organizatës Shtetiëeb
------	----------------	--------------------------------------

Znj.	Irma Kopliku	Anëtare e Parlamentit / Lektore pranë Universitetit të Shkodrës
------	--------------	---

Znj.	Jerina Vataj	Këshilltare e LSI pranë Këshillit Bashkiak Lezhë
------	--------------	--

Znj.	Jolanda Mustafaraj	Këshilltare e PS pranë Këshillit Bashkiak Durrës
------	--------------------	--

Znj.	Lindita Pali	Këshilltare pranë Këshillit Bashkiak Burrel
------	--------------	---

Znj.	Marsida Duli	Doktoreshë / Aktiviste e PD
------	--------------	-----------------------------

Znj.	Mirjeta Gjonec	Këshilltare e PD pranë Këshillit Bashkiak Bajram Curri
------	----------------	--

Z.	Oljan Kanushi	Koordinator pranë Këshillit të Ministrave
----	---------------	---

Z.	Sofjan Jaupaj	Këshilltar i Ministrit të Kulturës
----	---------------	------------------------------------

Znj.	Tresi Trebicka	Menaxhere programesh mbi zhvillimin e qëndrueshëm pranë "Eco Partners Albania"
------	----------------	--

Znj.	Arsela Gjonaj	Specialiste pranë Këshillit Bashkiak Tiranë / Lektore në universitetin e Beratit
------	---------------	--

Z.	Dritan Cekani	Nëndrejtor i Përgjithshëm i Doganave / Aktivist i Partisë Socialiste
----	---------------	--

Z.	Elidon Lamani	Menaxher projektsh pranë organizatës "Qendra Rinore e Vlorës" / Aktivist i shoqërisë civile
----	---------------	---

Z.	Endri Mykaj	Këshilltar ligjor pranë Këshillit të Ministrave
----	-------------	---

Znj.	Enisa Halili	Specialiste pranë drejtorisë së Planifikimit strategjik të Bashkisë Tiranë
------	--------------	--

Z.	Erlis Hereni	Këshilltar ligjor pranë ministrit të Brendshëm / Drejtor ekzekutiv i "Aleancës së Rinisë Shqiptare"
----	--------------	---

Z.	Florjan Mucaj	Nënkryetar i Bashkisë Fier / Aktivist i Partisë Socialiste
----	---------------	--

Z.	Francesko Mucaj	Sekretar politik i forumit rinor të Partisë Socialiste
----	-----------------	--

Znj.	Ina Metko	Juriste, Ministria e Integritit Evropian
------	-----------	--

Z.	Juel Jarani	Zv.rektor në Universitetin e Sporteve
----	-------------	---------------------------------------

Znj.	Juliana Cici	Zv.komisionere pranë "Avokatit të Popullit"
------	--------------	---

Z.	Lulzim Omuri	Këshilltar i minibashkisë nr. 2, Tiranë / Aktivist i forumit rinor të Partisë Demokratike
----	--------------	---

Znj.	Magi Apostoli	Koordinatorë projekti pranë "Europartners Development"
------	---------------	--

Znj.	Pranvera Myrselaj	Menaxhere financiare pranë "System Group Albania"
------	-------------------	---

Z.	Redi Saliasi	Përgjegjës i PR dhe komunikimit pranë kompanisë "Croën Agents"
----	--------------	--

Znj.	Rikelda Balliu	Koordinatorë e projektit të Bashkimit Evropian pranë drejtorisë së doganave
------	----------------	---

Znj.	Vjollca Dako	Drejtoreshë ekzekutive e fondacionit mediatik "Dritan Hoxha"
------	--------------	--

VITI 2015

Z.	Admir Malaj	Këshilltar pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
----	-------------	--

Znj.	Amela Juka	P.administratë / Politikal activist DP
------	------------	--

Znj.	Arlinda Hoti	Drejtoreshë e trajnimeve, Shkollë Shqiptare e Administratës Publike
------	--------------	---



Znj. Ramiola Kalemi	Lektore, pranë Univ. Durrës / Këshilltare bashkiake e PD-së, Durrës
Znj. Romira Muka	Lektore në Universitetin e Shkodrës / Këshilltare bashkiake e PD-së, Shkodër
Znj. Senida Mesi	Eksperte kontabël / Këshilltare bashkiake e PS-së, Shkodër
Z. Vaeld Zhezha	Këshilltar i ministrit të Mjedisit
Znj. Zamira Mustafaraj	Inxhinierë / Këshilltare bashkiake e PS-së, Durrës
Znj. Zarie Visha	Drejtoreshë shkolle / Këshilltare bashkiake e LSI-së, Kukës

VITI 2017

Znj. Adriana Hatellari	Mjeke / Anëtare e Këshillit Bashkiak Durres (LSI)
Z. Arber Kodra	Drejtor Ekzekutiv i Open Mind Spectrum Albania (OMSA)
Znj. Aurora Ndreu	Eksperte ligjore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë / Lektore pranë Akademisë Profesionale të Biznesit
Znj. Bora Muzhaqi	Konsulente e legjislacionit fiskal, "Ernst & Young Albania"
Znj. Brisela Kadaja	Drejtuese Shkolle / Anëtare e Këshillit Bashkiak Shkodër (PS)
Z. Dritan Palnikaj	Këshilltar, Këshilli i Ministrave
Z. Enton Duro	Lektor, Universiteti i Tiranës / Këshilltar pranë ministrit të Financave
Znj. Enxhi Mero	Eksperte e dep. programeve ndërkufitare, Ministria e Integritetit
Z. Erion Cerekja	Kryetar i Dhomës së Tregëtisë Shqipëri -Turqi
Z. Erlis Hoxha	Drejtori i protokollit dhe arkivës Bashkia Tirane / Aktivist i PS

VITI 2016

Znj. Albana Kraja	Shefe e njësies së përkthimit, Parlamenti Shqiptar
Znj. Armela Mitku	Anëtare e Këshillit Drejtues të FRD / Specialiste pranë Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, Tiranë
Z. Besard Buzi	Ekspert vendor pranë Këshillit të Evropës
Z. Besfort Lamallari	Kërkues -Autor i raportit vjetor "Freedom House"
Znj. Brikena Hoxha	Asistente ekzekutive pranë bankës "Societe Generale Albania"
Znj. Eda Lika	Asistente ligjore, Zyra e Kryeministrit
Znj. Edlira Osmani	Kërkuese / Koordinatorë pranë misionit EURALIUS
Z. Eneo Zguri	Anëtar i Këshillit Kombëtar të PD
Z. Eraldo Xhani	Këshilltar i grupit parlamentar të PS / Kreu i Dep. Cilësisë, Posta Shqiptare
Znj. Freskida Miloti	Producente dhe gazetare pranë Radio "Tirana"
Z. Indrit Puteci	Këshilltar i kryetarit të bashkisë Tiranës
Znj. Juliana Memaj	Kryetare e Bashkisë Ura Vajguore
Znj. Julinda Mansaku	Avokate pranë Avokatit të Shtetit
Znj. Krisilda Fana	Shefe e dep. koordinimit me institucionet dhe HR, Presidenti i Republikës
Znj. Manjola Hidri	Eksperte e projekteve IPA pranë Ministrisë së Integritetit
Znj. Manushaqe Rina	Lektore në Univer. e Durrësit / Këshilltare bashkiake e PD-së, Durrës
Znj. Mina Skuqi	Juriste / Asistente e nënkryetarit të Parlamentit
Znj. Mirbana Bilali	Drejtoreshë ekzekutive e kompanisë "Security & Protection Group"
Znj. Olta Kepucka	Shefe e Burimeve Njerëzore dhe Financave, GIZ Shqiptari
Znj. Orneta Liperi	Kryeredaktore e revistës "Monitor"

Znj.	Ersida Teliti	Drejtores e "Qendra e Konsumatorit" / Lektore, Universiteti i Tiranës
Z.	Gjergj Prabitaj	Drejtor i Uzinës Mekanike, Bashkia Tiranë / Aktivist i PS
Z.	Isuf Shehu	Themelues i Primis Law, Tax & Strategic Planning / Administrator, Advanced Systems & Technology shpk
Z.	Ivi Bejtja	Sekretar i Forumit Rinor PD
Znj.	Lindita Doda	Mësuese / Anëtare e Këshillit Bashkiak Mat (DP)
Znj.	Lindita Shehu	Financiere / Anëtare e Këshillit Bashkiak Dibrë (PDIU)
Znj.	Lindita Sotiri	Këshilltare e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë
Znj.	Lorisa Ylli	Koordinator, Qendra Shqiptare e Politikave / Aktiviste PD Durres
Znj.	Minushe Lazaj	Sekretare e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Kuvendi Shqipërisë
Znj.	Mona Xhexhaj	Kërkuese / Koordinatorë projekti pranë EMA
Z.	Renato Demiraj	Specialist IT, Shkolla e Administratës Publike / Aktivist i PS
Z.	Soljan Celibashi	Partner menaxhues, CC Law Office
Znj.	Ujvara Ponari	Këshilltare diplomatike, Institucioni i Presidentit të Republikës
Znj.	Zana Elezi	Mjeke / Kryetare e Këshillit Bashkiak Klos (PD)

VITI 2018

Z.	Besart Mataj	Drejtor i komunkimi pranë Shërbimit Shtetëror të Punësimit/ Aktivist i PS
Z.	Bledar Qalliu	Këshilltar pranë Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Evropës
Znj.	Briselda Zhuzhi	Asistente ekzekutive pranë Institucionit të Presidentit të Republikës
Z.	Donjet Gjoka	Ekspert në departamentin e Strategjive dhe Politikave, Ministria e Brendshme

Znj.	Erinda Toska	Menaxhere programi, Programi i Zhvillimit të Rajoneve
Znj.	Geldona Metaj	Menaxhere projekti në Pjesëmarrjen e Gruas në Vendimmarrje / Lektore pranë Univ. Tiranës
Znj.	Jetmira Sula	Eksperte e B.NJ. Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burjeve
Znj.	Jonada Mamo	Anëtare e Këshillit Bashkiak Durrës PDIU/Lektore në Univ. e Durrësit
Z.	Klevi Pojana	Nënkryetar i Lëvizjes Rinore për Integrim
Znj.	Ledia Lila	Specialiste pranë Bashkisë Tiranë/Aktiviste e Forumit Rinor të Partisë Demokratike
Znj.	Megi Melani	Eksperte e Integritimit Evropian pranë Ministrisë së Financave
Z.	Rezar Balla	Gazetar/Ekspert i PR pranë "Lëviz Albania"
Znj.	Rosela Gjylbegu	Drejtoreshë e Protokollit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Parlamenti
Z.	Sidrit Tako	Këshilltar pranë Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë
Znj.	Stela Kruja	Drejtoreshë e projekteve të zhvillimit rajonal, Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Znj.	Valbona Gogu	Drejtoreshë e projekteve të Asistencës së Huaj, Ministria e Mjedisit
Znj.	Valmira Guzi	Menaxhere projektsh / Lektore pranë Univ. Elbasanit

VITI 2019

Znj.	Albina Nanaj (Fërko)	Anëtare e Këshillit Bashkiak Tiranë (PDIU / PJIU) / Këshilltare e Drejtorit të Përgjithshëm, ISSH
Z.	Alsaed Sinani	Specialist Ligjor pranë Komisionerit Publik
Z.	Arvit Osja	Drejtoreshë e degës së PS, Shkodër
Znj.	Bjorka Duka	Asistente ekzekutive e Ministres së Drejtësisë
Znj.	Blerina Balla	Specialiste e shoqërisë civile dhe njësisë gjinore, Prezenca e OSBE
Znj.	Blerina Fani	Specialiste e programit ligjor, Prezenca e OSBE

Znj.	Blerina Guga	Drejtoreshë e Drejtorisë Zhvillimit dhe Koordinimit, Këshilli i Qarkut Tiranë
Z.	Danijel Hyseni	Koordinator pranë "Roma Active Albania"
Znj.	Edita Shoshi	Aktiviste e PS në Shkodër / Administratore e "Scutari shpk"
Znj.	Elena Pici	Specialiste, Departamenti i Investimeve dhe Donatorëve të Huaj, Zyra e Kryeministrit
Znj.	Elkana Zyka (Himci)	Eksperte për programet CBC, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Z.	Elvis Ponari	Specialist pranë "Albgaz sha"
Znj.	Esmeralda Byberi	Këshilltare e kryetarit të Bashkisë Tiranë
Z.	Fatjon Kthupi	Analist, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit
Z.	Fatri Islamaj	Gjyqtar, Gjykata e Apelit Tiranë
Znj.	Flavia Djaloshi	Këshilltare pranë Parlamentit
Z.	Florian Tahiri	Nënkryetar i Bashkisë Durrës / Lektor pranë Univ. Epoka
Z.	Gaetano Doci	Sekretar i grupit parlamentar të LSI
Z.	Halit Valteri	Deputet i Parlamentit Shqiptar
Z.	Marsid Bello	Ekspert ligjor, "Albgaz sha"
Znj.	Pranvera Gagani	Shfete e departamentit të zhvillimit ekonomik dhe turizmit, Bashkia Durrës
Znj.	Ray Koci	Menaxhere projekti pranë ANNTARC
Znj.	Saniela Xhaferi	Kryetare e FRESSH Vlorë / Lektore pranë Univ. Tiranës
Z.	Sead Kazanxhiu	Koordinator pranë Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA)
Znj.	Silvia Qesku	Asistente ekzekutive e Ministres së Financave dhe Ekonomisë
Z.	Xhenson Cela	Ekspert i Punësimit pranë PNUD
Znj.	Zoica Bardhi	Drejtoreshë e drejtorisë së turizmit Berat / Aktiviste civile

*Pozicioni i referohet profilin të mbajtur në periudhën e pjesëmarrjes në program

ASP AKADEMIA E STUDIMEVE POLITIKE PUBLIKIME



Zgjedhje në pandemi, praktika dhe rekomandime

Ky dokument teknik synon t'i ofrojë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe aktorëve të tjerë të përfshirë praktikën më të mirë të zbatimit të kërkesave të reja nën situatën e pandemisë së Covid-19 për të mos cenuar integritetin e zgjedhjeve.



Pasaporta e votuesit 2021

Broshura informuese përmban të gjitha risitë e Kodit Zgjedhor për zgjedhjet e 25 prill 2021, me qëllim njohjen e tyre dhe zbatimin e duhur të së drejtës dhe përgjegjësisë për të votuar. Botimi u financua nga ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Tiranë.



Ekstremizmi i dhunshëm në platformat online

Studimi identifikon situatën e elementëve të ekstremizmit të dhunshëm online si dhe ofron të dhëna të vlefshme për ndërtimin e politikave përkatëse për të ofruar një mjedis elektronik të sigurt. Botimi u financua nga Ambasada e SHBA në Tiranë.



Të rinj të sigurt nga propaganda ekstremiste online

Interneti është një nga hapësirat ku nevojitet të forcohet edukimi për të njohur dhe kundërshtuar mesazhet e propagandës ekstremiste. Ky udhërrëfyes ofron disa këshilla për të krijuar rezistencën e duhur ndaj ekstremizmit të dhunshëm online.



Rrugëtimi drejt BE, sfidat dhe mundësitë

Studimi analizon problematikat të cilat dëmtojnë dhe nuk maksimizojnë përfitimin e Shqipërisë në kuadër të procesit të integrimit evropian të vendit. Botimi është pjesë e projektit "Roli i Shoqërisë Civile në procesin e integrimit në BE në Shqipëri".



30 praktika të mira të bashkëpunimit të aktorëve vendorë

Publikimi elektronik prezanton praktika të mira të bashkëpunimit të autoriteteve vendore dhe shoqërisë civile në Poloni, Itali dhe Shqipëri, me fokus promovimin e modeleve evropiane të qeverisjes vendore. Botimi u mbështet nga Bashkimi Evropian.

Akademia e Studimeve Politike

Rruga Emin Duraku,
Pallati mbi bankën Credins,
Kati 7, ap 21, Tiranë

Tel: +355 45629047
E-mail: info@asp.al
Web: www.asp.al

Në rubrikën "Publikime" të faqes sonë www.asp.al mund të shkarkoni të gjitha botimet në versionin pdf. Skanoni këtë kod për më tej QR CODE



- Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike
- Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike
- Akademia Studimeve Politike
- Akademia e Studimeve Politike

Programi i Shkollës së Studimeve Politike financohet nga Këshilli i Evropës dhe Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë si edhe vetë kontributet e pjesëmarrësve

